

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kur James Bondi kthehet në Menekshe: Telendisja në telenovelë turke, e një spy story
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/23/kur-james-bondi-kthehet-ne-menekshe-telendisja-ne-tele-novele-turke-e-nje-spy-story/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:50:31 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 16:29:41 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3a4ee092eb6e8335bffe160b346e20b9ac5da19aa54a049427b5c1fd1b5caba5
TEKSTI	3890e337ca40161d47d4669ae9680c26319faf28265cc373120add8d0acd74d8
PAMJA	d14a48f51cd606f94825e95dd1c907ba3e12aa1d45e1fde3ac9565fdcf2b4f21

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5e79272331aa69c081e2c45f277ddcb5f4fbbc6a7643db19031eef98c59b5bc9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5e79272331aa69c081e2c45f277ddcb5f4fbbc6a7643db19031eef98c59b5bc9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kur James Bondi kthehet në Menekshe: Telendisja në telenovelë turke, e një spy story

Analizë

Publikuar: 23/09/2026

f X



Nga Ylli Pata

Historia që SPAK i dhuroi publikut ishte një fabul e mrekullueshme. Një kryespione nga Kosova që telefonon një garipi durrsak në panik, në stres që kërkon një ngushëllim. Një fjalë, një gjest të butë që t'i qetësojë shpirtin, mendjen e ikur për bojë, ndoshta edhe të rënduar nga municione izotrope.

Por askush nuk i flet, askush prej miqve që kishte ngrënë e pirë nuk i përgjigjet. Telefoni, i cili nuk i pushonte asnjë minutë, në çdo kohë të ditës 24/7 është shurdh.

Është vetëm një grua që në momentin më të vështirë të jetës së tij mundohet ta qetësojë. Shpirt, mblidhe mendjen. Gjërat duhet t'ja lëmë kohës. Por garipi është në stres dhe e çmend me telefon. Gruaja ja kthen: Jam në takim të rëndësishëm, me shefin, me njërin me tjetrin....

Kjo histori është një material perfekt për një James Bond shqiptar, ku Gysi është 007-a e Vlora zonja M.

Por s'ka, e kthyen në telenovelë trogloditët e paneleve, duke e keqpërdorur një material të artë për një film që ndoshta vitin e ardhshëm mund të na kishte përfaqësuar në Oscar. Se këtë vit, shqyrr zotit, është pranuar kryevepra e Roland Sejkos "Film di Stato", që po bën namin në kinematë italiane e sipas gjasave do na sjellë një lajm të mirë nga Los Angelosi.

E gjithë fabula që na ka sjellë deri tani prokuroria speciale është magjepsë, mjafton ta studiojmë me kujdes. Pasi aty ka dilema, ka dramë, ka edhe romancë, po mbi të gjitha ka suspense siç i thonë francezët. Por që ta sjellësh gjithë këtë material në skenë duhet Vera Grabecka, e jo trogloditët që e shpërthejnë gjithë këtë

Me te lexuarat

Gratë e PD-së që u shtrinë në zyrën e Gys Agasit, njëra u shfaq me makinë 70 mijë Euro me taksë /

"Do përfundojmë keq shpirt". Si raportonte kryeagjentja Vlora Hyseni te

Benet Becit, si po i pastron paratë e korrupsionit me tandra n...

Te gjithë e dinin në Baku, Vlora Hyseni shfaqet në Kosovë dhe dorëzohet te

Isufi dhe Mauro Borghi që helmojnë shqiptarët me djathë me baktere të rrezikshme, ...

duhet vera shpesh, e jo treguaret qe e shprehne gjene keto kryeveper letrare ne Menekshe.

Ka manual për të kthyer një ngjarje reale në vepër letrare e më pas në kinematografi. Duhet mëndje, jo britma panelesh. “Dueli i Heshtur”, një nga kryeveprat shqiptare të filmit ka pasur firma të rënda, ku skenari është i Nasho Jorgagjit e regjia e Dhimitër Anagnostit. Pa përmendur aktorët: Ndreke Luca, Rikard Larja, Reshat Arbana, Bujar Kapexhiu.

Një spy story e punuar me kujdes mund të na çojë në Netflix e të bëjë bujë. Për këtë kërkon dramë; që ka, romance; që paska, protagonistë tërheqës, të cilët ekzistojnë. Janë të gjithë elementët, vetëm se duhet një kujdes në renditjen dhe nuancat e dialogjeve.

Do të dilte një kryevepër deri në dërgimin e çështjes në gjyq. E pastaj ta ndjekim procesin siç ndjekim Gërdecin, ku Gysi del nga gjykata i buzëqeshur e ashtu tërheqës dhe përshëndet para kamerave. Ku e ke Vlorën e pyesin? Unë jam nga Durrësi thotë duke qeshur dhe ikën me avokatin...

Tema

TAG: [sharkimi i vlora hysenit](#) [Telenovelë turke](#)

Të ngjashme



“Me burg të dënohen ata që bëjnë vrasje”, Manjani kundër dënimit të Veliajt: Nuk duhej të ishte arrestuar!



Paaftësia e një deputeti “antikomunist” për të kuptuar krimet e komunizmit



Armiqtë imagjinarë dhe shënjestra e prishur e opozitës

Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. ‘Prapaskena’ është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësura me interesat klienteliste, krimin dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

- [KREU INVESTIGIM](#)
- [KRIM & KORRUPSION](#) [DOSJE ROZË](#)
- [KRYESORE](#) [POLITIKË](#) [EKONOMI](#)
- [ANALIZË](#) [RAJON](#) [KULTURË](#) [SPORT](#)

ndershem, te cilet ne bashkepunim
përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.